



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL DURRËS

Nr. Prot _____

Data ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Transport dhe asgjësim i mbetjeve spitalore per Spitalin Rajonal Durres”

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Durres ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlloritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlloritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;

Argumentimi: Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 8;**

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Kritereve të Përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 40 % e vlerës së pritshme të kontratës për të cilën konkuron operatori ekonomik.

2.2.2 Kopje të certifikuara/vërtetuara të bilanceve për vitet 2021, 2022 dhe 2023 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet;

Argumentimi: Keto kritere, jane vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,”Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një **xhiro vjetore minimale** të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në **bilancet** e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*”; si dhe ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të **xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të

xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates ose lotit ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 i ndryshuar ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat si me poshtë vijon:
 - A. ISO 9001 (Sistemi Menaxhimit të Cilesisë) ose ekuivalent;
 - B. ISO 14001 (Sistemi Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalent;
 - C. ISO 45001 (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë së punetoreve në punë) ose ekuivalent

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 123 të Ligjit 162, Datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", ku përcaktohen se "1. Autoriteti ose enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë ose që lidhen me punësimin.

2. Leje mjedisi Tipi A (Kodi III.1.C) "Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi" së bashku me Akt Miratimin përkatës,

Argumentimi: referuar Ligjit 10 448, Datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe neni 53, 54, 57, 58 dhe 59 të Ligjit 10 463, Datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", si dhe Referuar nenit 77 të Ligjit 162, Datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik dhe nenit 41 pika 4/a të VKM 285, Datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar

3. Licence Tipi III.2.B, për Lejen e mjedisit të Tipit A, ku të këtë të përfshira asgjesimin e mbetjeve me kode **180102, 180106, 180107, 180108 dhe 180109**

Argumentimi: referuar Ligjit 10 448, Datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe neni 53, 54, 57, 58 dhe 59 të Ligjit 10 463, Datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", si dhe Referuar nenit 77 të Ligjit 162, Datë 23.12.2020 "Për prokurimin

Publik dhe nenit 41 pika 4/a të VKM 285, Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

4. Leje Mjedisi Tipi A (Kodi III.1.C) ose Leje Mjedisi Tipi B (Kodi III.1.B) “Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1.a) ose lëndfillimit (5.2 a)”, së bashku me Akt Miratimin përkates,

Argumentimi: referuar Ligjit 10 448, Datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe neni 53, 54, 57, 58 dhe 59 të Ligjit 10 463, Datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe Referuar nenit 77 të Ligjit 162, Datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik dhe nenit 41 pika 4/a të VKM 285, Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

5. Licence Tipi III.2.B, për Lejen e mjedisit të Tipit A ose të Tipit B, ku të këtë të përfshira asgjësimin e mbetjeve me kode **180101, 180103**,

Argumentimi: referuar Ligjit 10 448, Datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe neni 53, 54, 57, 58 dhe 59 të Ligjit 10 463, Datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe Referuar nenit 77 të Ligjit 162, Datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik dhe nenit 41 pika 4/a të VKM 285, Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjeno –Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të leshuar nga ISHS (Inspektoriati Shendetesor Shteteror);

Argumentimi: në përputhje me kërkesat e nenit 10 të Ligjit 7643, Datë 12.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, dhe të nenit 10.3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave 798, Datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”

7. **Raport Monitorimi** për shkarkimet e Autoklavës dhe Inceneratorit i kryer nga një laborator i akredituar ku operatori të tregojë se zbaton normat për mbrojtjen e mjedisit. Në raport të jetë përfshirë fletë analizë e produktit përfundimtar të Autoklavës dhe Inceneratorit dhe të jetë e identifikueshme që produkti përfundimtar përmbush kërkesat e Landfillit ku do të depozitohen mbetjet pas trajtimit.

Argumentimi: referuar Ligjit 10448, Datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe Ligjit 10 431, Date 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”

8. Një vetëdeklarim se: Pas kryerjes së shërbimit do të dorëzojë vërtetim me shkrim që ka trajtuar/asgjësuar mbetjet sipas kërkesave të Kontratës dhe si dokument do të sjellë të gjithë shiritat e punës (kopje) të autoklavës dhe inceneratorit për sasinë e mbetjeve të tërhequra nga SRD të cilat janë trajtuar/asgjësuar në impiantin e tij, dhe flete analizat periodike nga laborator i akredituar për cilësinë e produktit përfundimtar të autoklavës dhe hirit të inceneratorit.

Argumentimi: referuar Ligjit 10 448, Datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe Ligjit 10 431, Datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” dhe të Ligjit 10 463, Datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

9. Një vetëdeklarim se do të instalojë 1 (një) banak frigoriferik sipas specifikimeve teknike dhe do ta mirëmbajë atë deri në përfundim të kontratës përfshirë disinfektimin e tij. Ashtu si kërkon kuadri rregullator ligjor për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore në RSH.

Argumentimi: Referuar neni 77 të Ligjit 162, Datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik dhe neni 41 pika 4/ç të VKM 285, Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

10. Operatori duhet të ketë në pronësi/qira, minimalisht 1 (një) **automjet** dhe për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:
- Leje Qarkullimi
 - Çertifikatë Pronësie ose aktin noterial te marrjes me qira
 - Siguracion
 - Leje Higjeno-Sanitare e mjetit
 - Çertifikate e Kontrollit Teknik
 - Fotot e mjeteve (brenda dhe jashtë)
- (Shënim: Në fotot e sjella duhet të jenë **qartësisht të dukshme targa, sinjalistika e detyrueshme dhe veshja e brendshme e automjetit** sipas percaktimeve te VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore” Shtojca 4) “Kushtet qe duhet te respektoje transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”)*
- Argumentimi:** Referuar neni 77 te Ligjit 162, Datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik dhe neni 41 pika 4/ç të VKM 285, Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” i ndryshuar dhe VKM 798, Datë 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore” Shtojca 4) “Kushtet që duhet të respektoje transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”
11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur me landfill të liçensuar për depozitim të produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/ asgjësimit, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Ky kriter kërket në përputhje me kërkesat e VKM 798, Datë 29.09.2010, pasi AK si krijuesi mbetjeve është përgjegjës deri në hallken e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijojnë.
- Argumentimi:** Referuar neni 77 të Ligjit 162, Datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik” dhe neni 41 pika 4/a të VKM 285, Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” i ndryshuar
12. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha shërbimeve. Për këtë operatori duhet të paraqesë dokumentacionin se ka punësuar dhe regjistruar në listpagesa ose me kontratë shërbimi:
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (një) Ekspert Mjedisor, të çertifikuar nga Institucioni Përkatës (Ministria e Mjedisit), për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin:
 - Librezë pune përkatëse
 - CV përkatëse
 - Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme përkatëse
 - Diplomë
 - Çertifikatë (Eksperti Mjedisor)
- Argumentimi:** Referuar neni 77 të Ligjit 162, Datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik” dhe neni 41 pika 4/a të VKM 285, Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” i ndryshuar
13. Operatori duhet të furnizojë me kontenitorë sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III. Për të provuar plotësimin e këtij kriteri, operatori duhet të paraqesë në ambjentet e SRD-së **në datën dhe orën e hapjes** së tenderit nga një mostër të paketimeve:
- Për mbetjet e mprehta, me KOD 18 01 01, **Kontenitor Plastik me 1 përdorim** (3 L ose 5L me tolerance diference 0.5L)
 - Për mbetjet me potencial infektues, me KOD 18 01 03, **Kontenitor Kartoni me Qese të Verdhë të loguar** me 1 përdorim (rreth 40L ose rreth 60L)
 - Të jenë të shoqëruara me qese që vendoset në pjesën e brendshme.

- ii. Të jenë ekologjikë (që nuk lëshojnë substanca gjatë djegjes)
- iii. Të jenë të palosshme për të zënë pak hapësirë në ruajtje, të lehta për t'u shpalosur dhe mbyllur, me mbajtëse anësore të shtangëta dhe të qëndrueshme.
- c. Për mbetjet anatomike, me KOD 18 01 02, **Kontenitor Plastik një përdorimesh** me ngjyrë të verdhë të loguara me 1 përdorim.
- d. Për mbetjet citostatike, me KOD 18 01 08, **Kontenitor Plastik një përdorimesh** me ngjyrë të kuqe ose kafe ose të zezë dhe qese me ngjyrë të kuqe ose kafe ose të zezë të loguara me 1 përdorim.

(Shënim: Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listen e inventarizimit. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të vecantë ose nëse mostra/t nuk është/janë në përputhje me specifikimet teknike, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht OE do të skualifikohet.)

Argumentimi: Referuar nenit 77 të Ligjit 162, Datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik” dhe neni 41 pika 4/a të VKM 285, Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

1. **Mbetje të mprehta** (instrumente të mprehta të përdorura, si për shembull: age, shiringa, bisturi, brisqe, pajisje të përziara, qelqe të thyera dhe të ndotura, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme) **KODI 180101** dhe **mbetje me potencial infektiv** (tamponë, fasho, pambuk të ndotur me gjak, tamponë, fasho të ndotur me lengje trupore, qeset e gjakut për transfuzion, sistemet e kateterëve, pjesë trupi të padallueshme/mostra indesh, tuba dhe filtra dialize, pelena nga pacientë të infektuar, shiringa të ndotura me gjak, tuba të ndotur me gjak, ampula plastike të ndotura me gjak, doreza kirurgjikale të përdorura/maska/përparëse) **KODI 180103** do të asgjësohen me **autoklavim**, sipas **VKM 798, Date 29.09.2010**, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”:
Shtojca 3) “Metodat për trajtim dhe asgjësim”,
Pika 2) Me autoklavim,
2. **Mbetjet anatomike**, (pjesë të trupit dhe organe, ose lengje të tilla si gjaku) **KODI 180102**; (Medikamente citostatike dhe citotoksike) **KODI 18 01 08**; (Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08) **KODI 18 01 09** do të asgjësohen me **incenerim** sipas **VKM 798, Date 29.09.2010**, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”
Shtojca 3) “Metodat për trajtim dhe asgjësim”,
Pika 1) “Incenerim”,
(Metodat e mesiperme të trajtimit janë të mbeshetura edhe në Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore dhe VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”)
3. Transporti i mbetjeve do të bëhet nga operatori me automjet duke respektuar standartin sipas **VKM 798, Date 29.09.2010**, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”
Shtojca 4) “Kushtet që duhet të respektoje transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”
4. Operatori duhet të sigurojë ambalazhin përkatës sipas specifikimeve të caktuara në **Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore**. Furnizimi me ambalazh 1 (një) përdorimesh (kontenitorë kartoni me qese të verdhë dhe kontenitorë plastik me kapak) do të bëhet çdo javë ose edhe më shpesh sipas kërkesës së AK.
5. Operatori duhet të instalojë një frigorifer (banak frigoriferik) në ambientet e SRD-se me një kapacitet më të madh se 200 litra dhe temperaturë -18°C për ruajtjen e mbetjeve të lëngshme dhe të ngurta deri në momentin e transportit me mjetet e tij për në impiantin e trajtimit. Pas marrjes së mbetjeve, operatori do të disinfektojë frigoriferin dhe ambientin përreth, si dhe do të bëjë mirëmbajtjen e frigoriferit.

6. Operatori ekonomik duhet të sjell në përdorim 2 (dy) peshore elektrike mbi 100 kg, një që shërben për të peshuar mbetjet e krijuara në pavion dhe një për të peshuar mbetjet që do të dorëzohen operatorit ekonomik. Peshoret duhet të jenë të kolauduar.
7. Mbetjet e mbledhura në kontenitorët perkates do të peshohen në prani të dy palëve duke u zbritur pesha e ambalazhit.
8. Operatori dhe Perfaqesuesit e SRD për çdo dorëzim mbetjesh tek operatori për asgjësim, do të plotësojnë “Dokumentin e Dorëzimit të Mbetjeve të Rrezikshme”, sipas **VKM 371, Date 11.06.2014**, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”.
9. OE bashkë me dokumentin e dorëzimit do të kthejë në Spital konfirmimin me shkrim se ka trajtuar/asgjësuar mbetjet spitalore sipas kërkesave të kontratës dhe do të bashkangjisë të gjithë shiritat e punës (kopje) të autoklaves/ inceneratorit për mbetjet e tërhequra nga Spitali. OE do të dorëzojë çdo 3-muaj flete – analizë nga laborator i akredituar të produktit përfundimtar të autoklaves dhe hirit të inceneratorit ku të tregohet cilesia e shërbimit sipas kërkesave të VKM 798, datë 29.09.2010.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit” ne **materialin me nr.893/3 prot., dt. 04.07.2024**, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Ngarkuar ne SPE nga njesia e prokurimit: